

STATUTI

I ORGANIZATËS KOMBËTARE ANTIDOPING

KREU I

PARIME TË PËRGJITHSHME

NENI 1

FORMA LIGJORE, PËRBERJA, SELIA

1. Organizata Kombëtare Antidoping (për efekt të këtij Statuti më poshtë do t'i referohemi OKAD) është person juridik, në formën e një organizatë jofitimprurëse (shoqatë), e cila perfaqëson një bashkim vullnetar, me themelues Federatën Shqiptare të Boksit, Federatën Shqiptare të Alpinizmit dhe Turizmit Malor dhe Federatën Shqiptare të Sporteve me Kuaj, që vepron në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit 8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar, ligjit nr. 79/2017 «Për Sportin», ligjit Nr.9242, datë 17.6.2004 "Për ratifikimin e Konventës Europiane Antidoping, 1989", ligjit nr. 9623, datë 16.10.2006 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare kundër dopingut në sport, 2005", Kodit të Agjencisë Botërore Antidoping dhe statutit të saj.
2. Kohëzgjatja e OKAD-së është me afat të pakufizuar.
3. Selia e OKAD-së është në adresën Rruga "Liman Kaba", Parku Olimpik, Tiranë.

NENI 2

SIGLA, EMBLEMA DHE VULA

1. Sigla e Organizatës Kombëtare Antidoping është OKAD.
2. Emblema e OKAD konsiston në një dizenjim të përbashkët të emrit ndërkombëtar të Shqipërisë të vendosur në pjesën e poshtme të një katrori, në mes të cilit është flamuri shqiptar, dhe në të djathtë të tij, sigla e OKAD, me emërtimin e saj, "Organizata Kombëtare Antidoping", në pjesën e poshtme.
3. Vula e OKAD është në formën rethore me emblemën e saj në qendër. Rreth emblemës shkruhet me gërma kapitale "Organizata Kombëtare Antidoping".



NENI 3

QËLLIMI

1. Organizata Kombëtare Antidoping është e vetmja organizatë e njohur nga Ministria përgjegjëse për sportin dhe asnjë tjetër organizatë, nuk mund të ushtrojë atributet e saj.
2. OKAD ka si qëllim të zhvillojë aktivitetin e edukimit, parandalimit të rasteve doping, kontrollit mbi përdorimin e grupeve farmaceutike të substancave apo metodave doping tek sportistët dhe të tjerë të lidhur me ta, shtetas apo rezidentë në Republikën e Shqipërisë.
3. Organizata Kombëtare Antidoping për kryen kontrollin e sportistëve dhe dënimin e përdoruesve të dopingut, anëtarë të Federatave Shqiptare të sportit, të cilat pranojnë autoritetin e organizatës në zbatim të ligjit nr.79/2017.

NENI 4

FUNKSIONET

1. Organizata Kombëtare Antidoping kryen funksionet e mëposhtme:
 - a) Planifikimin, bashkërendimin, zbatimin, monitorimin e Kontrollit të Dopingut;
 - b) Bashkëpunimin me organizatat, agjencitë përkatëse kombëtare dhe Organizata të tjera Antidoping;
 - c) Inkurajimin e kryerjes reciprokisht të Analizave ndërmjet Organizatave Kombëtare Antidoping;
 - d) Planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e programeve informative, edukative dhe parandaluese antidoping;
 - e) Nxitjen e kërkimeve antidoping;
 - f) Ndjekjen e të gjithë shkeljeve të mundshme të rregullave antidoping, brenda juridiksionit të saj, duke përfshirë hetimin nëse personeli i mbështetjes së sportistëve/ ose persona të tjerë mund të jenë përfshirë në çdo rast dopingut për të siguruar ekzekutimin e duhur të pasojave;
 - g) Zhvillimin e një hetimi automatik për personelin e mbështetjes të sportistëve, brenda juridiksionit të tij, në rastin e një shkeljeje të rregullit anti-doping nga një i mitur dhe e çdo personeli të mbështetjes së sportistëve, që konstatohet që ka kryer një shkelje të rregullit anti-doping;



- h) Bashkëpunimin e plotë me Agjencinë Botërore Antidoping, në lidhje me hetimet e zhvilluara prej saj, në pajtim me nenin 20.7.10 të Kodit të Agjencisë Botërore Antidoping.

KREU II

ANËTARËSIA

NENI 5

ANËTARËT

1. Anëtarët e Organizatës Kombëtare Antidoping janë persona juridikë, (Federata Shqiptare Sportive).
2. Anëtarët e regjistruar në OKAD janë të detyruar të kontribuojnë për OKAD, nëpërmjet pagimit të kuotizacionit të përcaktuar nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI 6

TË DREJTAT E ANËTARËVE

Anëtari i OKAD-së ka të drejtë ;

1. Të pajiset me kartën e anëtarësimit;
2. Të pajiset me statutin dhe rregulloret e OKAD-së.
3. Të përfaqësohet me të drejtë vote në Asamblenë e Përgjithshme të OKAD-së.
4. Të informohet me vendimet e Komitetit Drejtues të OKAD-së .
5. Te pajiset falas me botimet e ndryshme që bën OKAD.
6. Te njihet më parë me programin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme dhe dokumentacionin përkatës.

NENI 7

DETYRIMET E ANËTARËVE

1. Të jetë korrekt ndaj OKAD-së, që nënkupton që çdo anëtar të mos ndërmarrë veprime kundër interesave të saj;
2. Te paguajë të gjitha detyrimet financiare ndaj OKAD;
3. Te njohë parimet e ndershmërisë, integritetit dhe sjelljes korrekte sportive;



4. Te njohë të gjitha detyrimet e tjera që dalin nga këto statute, rregullore, direktiva dhe vendime të OKAD.

NENI 8

HUMBJA E STATUSIT TË ANËTARIT DHE PEZULLIMI

1. Statusi i anëtarit mbaron me dorëheqjen ose përjashtimin e anëtarit.
 - a. Dorëheqja e anëtarit bëhet me kërkesë me shkrim.
 - b. Një anëtar mund të paraqesë me shkrim kërkesën e tij për dorëheqje në sekretariat, i cili duhet të shprehet brenda 30 ditëve, në lidhje me kërkesën e paraqitur.
 - c. Përjashtimi i anëtarit ndodh në rast të mospagimit të kuotizacionit vjetor për dy vite rradhazi.
 - d. Humbja e statusit të anëtarit, nuk e liron atë nga detyrimet e veta financiare të papërbushura kundrejt OKAD-së ose anëtarëve të tjerë.
2. Pezullimi i anëtarit të OKAD-së ndodh në rastin e konstatimit të shkeljeve të Statutit, Rregulloreve, direktivave dhe vendimeve të OKAD-së.
 - a. Pezullimi apo përjashtimi i anëtarit bëhet me vendim të arsyetuar të Asamblesë së Përgjithshme.
 - b. Vendimi i pezullimit përmban edhe afatin kohor të pezullimit, i cili nuk mund të jetë më shumë se 6 muaj.
 - c. Pezullimi e përjashton atë nga të drejtat që lidhen me kapitalin e regjistruar në OKAD.

KREU III

ORGANIZIMI

NENI 9

ORGANET E ORGANIZATËS KOMBËTARE ANTIDOPING

1. Organet drejtuese të OKAD-së- janë:
 - a. Asambleja e Përgjithshme;
 - b. Presidenti;
 - c. Komiteti Drejtues
 - d. Sekretari i Përgjithshëm
2. Komisionet:
 - a. Komisioni mediko- ligjor i disiplinës;
 - b. Komisioni mediko - ligjor i Apelit;
 - c. Komisioni i çështjeve shëndetësore dhe promovimit;
 - d. Komisioni teknik i kontrollit të doping dhe përjashtimit të përdorimit terapeutik;



NENI 10

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë ligjvënës dhe vendimarrës dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e saj, të cilët kanë të drejtën e barabartë të votës.
2. Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, kur janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.
3. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë ose (50%+1) të anëtarëve të pranishëm.
4. Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme thirret nga Komiteti Drejtues, jo më pak se një herë në vit, sipas datës së caktuar nga Komitetit Drejtues.
5. Rendi i ditës vendoset nga Komiteti Drejtues dhe i dërgohet anëtarëve 10 ditë përpara datës së Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 11

KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme e OKAD ka këto kompetenca:
 - a. Miraton ndryshime të statutit në përputhje me ligjin për sportin.
 - b. Miraton llogaritë vjetore të saj.
 - c. Miraton raportin e Komitetit Drejtues.
 - d. Voton buxhetin e saj.
 - e. Miraton rregulloret Antidoping në përputhje me Kodin e Agjencisë Botërore Antidoping.
 - f. Miraton organin e kontrollit financiar të pavarur nga OKAD, sipas ligjeve në fuqi.
 - g. Zgjedh Presidentin.
 - h. Zgjedh anëtarët e Komitetit Drejtues.
 - i. Miraton pranimin apo dorëheqjen e një anëtari sipas parashikimit në këtë statut
 - j. Deklaron shkrirjen e OKAD dhe likuidimin e veprimeve të saj financiare.
 - k. Miraton kalendarin e aktiviteteve të programuara nga Komiteti Drejtues.

NENI 12

EMËRIMI I DELEGATËVE

1. Anëtarët dërgojnë pranë Sekretariatit të OKAD emrat e delegatëve zyrtarë të cilët janë persona zyrtarë të autorizuar për përfaqësim dhe konfirmimin e pjesëmarrjes së tyre, jo më vonë se 20 ditë, përpara datës së zhvillimit të Asamblesë së Përgjithshme.
2. Delegatët zyrtarë të Federatave Shqiptare Sportive duhet kenë dokumentin zyrtar



- (autorizim dhe ose prokurë), që vërteton se ai është përfaqësues me të drejtë vote.
3. Delegatët zyrtarë duhet të kenë dokumentin e identifikimit (kartë identiteti, pasaportë, etj)
 4. E drejta e votës nuk mund t'i delegohet një anëtar tjetër.

NENI 13

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ZAKONSHME

1. Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme thirret nga Komiteti Drejtues jo më pak se një herë në vit. Njoftimi për mbledhjen e Asamblesë duhet t'u dërgohet anëtarëve 30 ditë përpara ditës së zhvillimit të saj.
2. Rendi i ditës vendoset nga Komiteti Drejtues.
3. Rendi i ditës, raportet e aktiviteteve, buxheti, llogaritë dhe çdo dokument tjetër duhet t'i dërgohen anëtarëve, 10 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 14

RENDI I DITËS PËR ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË ZAKONSHME

1. Rendi i ditës për Asamblenë e Përgjithshme të zakonshme duhet të përfshijë të paktën çështjet e mëposhtme:
 - a) Verifikimi i përbërjes së mbledhjes.
 - b) Raporti i Presidentit.
 - c) Miratimi i raportit të aktiviteteve të K.D-së.
 - d) Miratimi i raportit financiar.
 - e) Miratimi i veprimtarive financiare për vitin pasardhës.
 - f) Zgjedhjet për çdo vend vakant.
 - g) Miratimin e audituesit të pavarur.
 - h) Shqyrtimi i propozimeve për amendamentet në statutin e OKAD-së.
 - i) Diskutime nga anëtarët për çështje të tjera.
2. Rendi i ditës mund të modifikohet nga një mazhorancë që përbën 2/3 të anëtarëve të pranishëm.
3. Në Asamblenë e Përgjithshme ftohen të marrin pjesë dhe përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse të Sportit.
4. Njoftimi zhvillohet 10 ditë përpara zhvillimit të Asamblesë së Përgjithshme.



NENI 15

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E JASHTËZAKONSHME

1. Komiteti Drejtues mund të thërrasë një asamble të përgjithshme të jashtëzakonshme, nëse mendohet se kjo është e domosdoshme.
2. Kur të paktën 1/3 e delegatëve të Asamblesë së OKAD -së bëjnë kërkesë me shkrim, K.D është e detyruar të thërrasë një Asamble të Përgjithshme të jashtëzakonshme jo më vonë se 30 ditë.
3. Njoftimi për mbledhjen e asamblesë së jashtëzakonshme duhet t'u dërgohet anëtarëve 20 dite përpara ditës së zhvillimit të saj.
4. Rendi i ditës si dhe çdo dokument tjetër duhet tu dërgohen anëtarëve 10 ditë përpara datës së mbledhjes.
5. Komiteti Drejtues vendos rendin e ditës në Asamblenë e Përgjithshme të Jashtëzakonshme.
6. Kur ajo mbahet me kërkesën e 1/3 të delegatëve, rendi i ditës duhet të përmbajë pikat e ngritura nga këta anëtarë.

NENI 16

VENDIMMARRJA

1. Asambleja e Përgjithshme mund të zhvillohet kur janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve (50%+1).
2. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.
3. Vendimet për ndryshime në statutin e OKAD-së, zgjedhja e Presidentit dhe e anëtarëve të Komitetit Drejtues, lirimi i një ose disa anëtarëve të një organi të OKAD-së, përjashtimi i një anëtarë të OKAD-së ose shkrirja e OKAD-së merren me një shumicë prej 2/3 e votave të anëtarëve të pranishëm.
4. Asambleja e Përgjithshme nuk duhet të marrë vendime për çështje që nuk janë parashikuara në rendin e ditës.
5. Vendimet duhet të merren me votim të hapur me përjashtim të rastit kur 1/3 e delegatëve kërkojnë votim të fshehtë.
6. Vendimet a marra nga Asambleja hyjnë në fuqi një ditë pasi ato janë miratuar, me përjashtim të rasteve kur Asambleja vendos për një datë më të mëvonshme.
7. Askush nuk mund të votojë për një çështje për sa kohë ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

NENI 17

DREJTIMI I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme duhet të drejtohet nga Presidenti ose në mungesë të tij nga një



zëvendëspresident. Kur edhe ai mungon mbledhja drejtohet nga anëtari me i vjetër i Komitetit Drejtues duke u emëruar kryetar i ditës.

2. Asambleja cakton komisionin e numërimit të votave të përbërë nga 3 - 5 persona.
3. Drejtuesi i mbledhjes është përgjegjës për respektimin e rendit të ditës. Ai përcakton edhe kohën në dispozicion të çdo anëtari për diskutim.
4. Procedura e mbajtjes së procesverbalit të mbledhjes së Asamblesë drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm i cili i dërgon ato tek anëtarët brenda 20 ditëve mbas datës së mbledhjes.

NENI 18

ZGJEDHJET

1. Zgjedhjet e anëtarëve të Komitetit Drejtues dhe Presidentit bëhen me votim të fshehtë. Ato janë periodike në çdo katër vjet.
2. Presidenti i Asamblesë është njëkohësisht edhe President i Federatës. Kandidati për president duhet të përmbushë këto kritere:
 - a. Të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri;
 - b. Të ketë arsim të lartë;
 - c. Të njohë gjuhën angleze.
 - d. Të ketë figurë të pastër morale;
 - e. Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaja;
 - f. Të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesave me postin e Presidentit;
3. Të drejtën për të kandiduar për postin e presidentit e kanë kandidatët e propozuar nga anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme dhe kandidatë të vetëkandiduar.
4. Çdo kandidat ka të drejtën të organizojë dhe zhvillojë aktivitete për paraqitjen e programit të tij.
5. Në raundin e parë, Presidenti zgjidhet me 2/3 e votave të vlefshme të të gjithë anëtarëve. Në rastet kur asnjë nga kandidatët nuk arrin këtë shumicë, bëhet një raund i dytë zgjedhjesh midis dy kandidatëve që kanë marrë më shumë vota në raundin e parë. Në raundin e dytë, kandidati që merr më shumë vota zgjidhet President. Në rastet e votave të barabarta, votimi do të përsëritet. Nëqoftëse edhe votimi i dytë përfundon me rezultat të barabartë, vendimi merret nëpërmjet hedhjes së shortit nga Komisioni i numërimit.
6. Kandidatët për anëtarë të Komitetit Drejtues, zgjidhen nga lista e personave që janë propozuar nga anëtarët e OKAD, të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave në Komitetin Drejtues.
7. Emrat e kandidatëve, bashkë me CV e tyre duhet të dërgohen pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të OKAD-së. Sekretariati i Përgjithshëm verifikon kandidaturat dhe ia paraqet rezultatet Komitetit Drejtues për miratim. Lista e aprovuar e kandidatëve, të cilët plotësojnë kushtet, i paraqitet përfaqësuesve të anëtarëve së bashku me rendin e ditës së Asamblesë. Për këtë veprimtari, Komiteti Drejtues duhet të ngrejë një komision të posaçëm për seleksionimin e kandidaturave, sipas kritereve të përcaktuara në këtë Statut.
8. Kandidatët për anëtarë të Komitetit Drejtues duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.
9. Ç'do kandidat duhet të propozohet nga të paktën një anëtar i OKAD -së, jo më vonë se 20 ditë para datës së asamblesë, në rendin e ditës të së cilës është përfshirë zgjedhja e presidentit dhe anëtarëve të Komitetit Drejtues.



NENI 19

DETYRAT E PRESIDENTIT

1. Presidenti është edhe kryetar i Komitetit Drejtues.
2. Detyrat e Presidentit janë si më poshtë:
 - a) Të përfaqësojë OKAD-në, si i vetmi përfaqësues i saj.
 - b) Të kërkoj thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme dhe të thërrasë mbledhjet e Komitetit Drejtues.
 - c) Të drejtojë Asamblenë e Përgjithshme po ashtu edhe takimet e Komitetit Drejtues.
 - d) Të sigurojë zbatimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe të Komitetit Drejtues.
 - e) Në rast se Presidenti mungon, detyrat mund t'i ngarkohen Zëvendëspresidentit.
 - f) Në rastin kur Presidenti jep dorëheqjen, Komitetit Drejtues cakton zëvendëspresidentin të kryejë funksionet e Presidentit përkohësisht, deri në thirrjen e Asamblesë së Jashtëzakonshme.

NENI 20

KOMITETI DREJTUES

Komiteti Drejtues është organi më i lartë ekzekutiv dhe përbëhet nga një numër, jo me pak se 5 vetë, duke përfshirë presidentin, zëvendëspresidentin dhe anëtarët e tjerë.

NENI 21

KOHËZGJATJA E MANDATEVE

1. Mandati i presidentit, dhe anëtarëve të tjerë të komitetit drejtues është 4 vjeçar. Ata kanë të drejtë të rikandidojnë.
2. Komiteti Drejtues plotëson vendin e mbetur vakant të anëtarit të tij në mbledhjen e Asamblesë së radhës, nëpërmjet votimit siç parashikohet në statut për zgjedhjet e OKAD.

NENI 22

MBLEDHJET

1. Komiteti Drejtues mbledhet jo më pak se gjashtë herë në vit dhe sa herë paraqitet e



NENI 24

VEPRIMTARIA

1. Komiteti Drejtues fillon mbledhjet vetëm kur janë të pranishëm me shumë se gjysma e anëtarëve të tij.
2. Komiteti Drejtues merr vendime me 50%+1 të anëtarëve të pranishëm. Në rastin e votave të barabarta. Presidenti ka votë vendimtare, kur votimi është i hapur.
3. Në rast se një anëtar i Komiteti Drejtues ka konflikt interesash me çështjen për të cilën debatohet, ai përjashtohet nga debati dhe votimi për këtë çështje.
4. Vendimet a marra regjistrohen në procesverbal.
5. Vendimet e marra nga Komiteti Drejtues hyjnë në fuqi menjëherë, përveç rasteve kur Komiteti Drejtues vendos ndryshe.

NENI 25

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

1. Sekretari i Përgjithshëm është organi administrativ i OKAD- së.
2. Kandidati për Sekretar të Përgjithshëm duhet të përmbushë këto kritere:
 - a) Të jetë shtetas shqiptar, me banim në Shqipëri.
 - b) Të ketë arsim të lartë.
 - c) Të njohë gjuhën angleze.
 - d) Të ketë figurë të pastër morale.
 - e) Të mos jetë i dënuar nga organet e drejtësisë shqiptare dhe të huaja.
 - f) Të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesave me postin e Presidentit.
3. Ai është përgjegjës për mbarëvajtjen dhe funksionimin e sekretariatit të përgjithshëm dhe për menaxhimin e stafit që punon brenda tij.
4. Funksionet e tij janë:
 - a) Të zbatojë vendimet e Komitetit Drejtues.
 - b) Të bëjë përgatitjet për Asamblenë e Përgjithshme.
 - c) Të programojë rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme dhe të mbledhjeve të Komitetit Drejtues.
 - d) Të njoftojë vendimet e Komitetit Drejtues anëtarëve të OKAD.
 - e) Ai është përgjegjës për veprimtarinë ekonomike financiare të OKAD.
 - f) Ai merr pjesë rregullisht në Asamblenë e Përgjithshme, në takimet e Komitetit Drejtues.



NENI 26

KOMISIONET

1. Komisionet janë të përbërë nga jo më pak se tre anëtarë, njëri prej të cilëve është Kryetari i tij.
2. Kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve dhe kohëzgjatja e tyre, përcaktohen në Rregulloren e funksionimit të Komisioneve, në përputhje me Kodin e Agjencisë Botërore Antidoping, të miratuar në Asambleenë e Përgjithshme.
3. Komisionet kanë funksionet e mëposhtme:
 - a) **Komisioni teknik i kontrollit doping dhe përjashtimit të përdorimit terapeutik** ngrihet për të kryer detyrat e mëposhtme:
 - Të planifikojë testime efektive të sportistëve, të ruajë integritetin dhe identitetin e mostrave, sipas standarteve ndërkombëtare të testimit dhe investigimit, të Agjencisë Botërore Antidoping.
 - Të shqyrtojë dhe të vendosë mbi kërkesën e sportistëve për përdorim të një substance ose Metodë të ndaluar për qëllime terapeutike.
 - b) **Komisioni mediko- ligjor i disiplinës** ka kompetencën të shqyrtojë dhe vendosë si shkallë e parë, për shkelje të Rregullave Anti-Doping, në përputhje me Kodin e Agjencisë Botërore Antidoping, për çdo sportist të licësuar nga Federatat Shqiptare Sportive.
 - c) **Komisioni mediko - ligjor i Apelit** ka kompetencë të shqyrtojë dhe vendosë si shkallë e dytë mbi ankimet, për çdo sportist të licësuar nga Federatat Shqiptare Sportiv.
 - d) **Komisioni i çështjeve shëndetësore dhe promovimit** ngrihet për të planifikuar, zbatuar dhe monitoruar programet informative, edukative dhe parandaluese antidoping.

KREU IV

NENI 27

OKAD DHE FEDERATAT SHQIPTARE SPORTIVE

1. OKAD monitoron programin e aktiviteteve antidoping të Federatave Shqiptare Sportive.
2. OKAD në zbatim të ligjit nr.79/2017, kërkon nga Federatat Shqiptare Sportive:
 - a) Të nxjerrin një program të aktiviteteve antidoping.



- b) Të sigurojnë informacionin konstant mjekësor individual për sportistët kryesorë dhe për këtë qëllim të nxjerrin aktet e nevojshme dhe të marrin masa konkrete.
- c) Të njoftojnë dhe realizojnë aktivitete edukimi antidoping me anëtarët dhe sportistët e tyre, të paktën një herë në vit, në lidhje me rregulloret e vlefshme për dopingun dhe pasojat e dëmshme për shëndetin, gjatë përdorimit të substancave doping.
- d) Të sigurojnë, nëpërmjet akteve të përgjithshme të përshtatshme që anëtarët e shoqatës të respektojnë detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i masave në luftën kundër dopingut në sport.
- e) Të caktojnë personat përgjegjës për të mbikëqyrur procesin e zbatimit të masave për parandalimin e dopingut.
- f) Të paraqesin në fillim të vitit OKAD-së, një kalendar me aktivitetet e tyre sportive dhe listën e sportistëve për kontroll doping.
- g) Të njoftojnë OKAD-në, të paktën një herë në gjashtë muaj, lidhur me planet, trajnimin dhe përgatitjen e sportistëve elitare dhe përzgjedhjet kombëtare.
- h) Të kontrollojnë programet antidoping të anëtarëve, si dhe të zhvillojnë këto programe.
- i) Të njoftojnë, në fund të vitit, OKAD-në dhe ministrinë përgjegjëse për sportin, lidhur me masat e marra në luftën kundër dopingut në vitin kalendarik.
- j) Të zbatojnë rregulla antidoping për sportet ku konkurrojnë kafshë, për pjesmarje në sportin përkatës, në pajtim me rregullat e Federatës Ndërkombëtare Sportive respektive.

KREU V

FINANCA

NENI 28

PERIUDHA FINANCIARE

Periudha financiare do të jetë viti kalendarik.

NENI 29

BURIMET FINANCIARE DHE TW ARDHURAT

1. Të ardhurat e OKAD-së sigurohen nga:
 - a. Fonde të dhëna nga Buxheti i Shtetit;
 - b. Regjistrimet vjetore të anëtarëve;
 - c. Nga sponsorizimet, donacionet, dhurimet, financimet nga shteti dhe burime të tjera të lejuara.
2. Të ardhurat që krijohen në OKAD nga burime të ndryshme ligjore, riinvestohen për zhvillimin e aktivitetit të OKAD-së. Pasuritë e luajshme dhe të paluajshme të OKAD do të përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të OKAD dhe nuk do të përdoren për të krijuar përfitime të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo tërthorazi për asnjërin nga themeluesit, ndonjë anëtar të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të organizatws.



[Handwritten signature in blue ink]

KREU VI

DISPOZITAT E FUNDIT

NENI 30

Dispozita te fundit

1. Për çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut ose për çështje të forcave madhore do të zgjidhen duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.97/2017, datë 27.04.2017 "Për Sportin", e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", i ndryshuar, ligjit nr. 8789, datë 07.05.2001 "Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse", si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë këtë aktivitet.
2. Çdo ndryshim i Statutit të OKAD-së përpara se të regjistrohet në Gjykatën kompetente, miratohet nga ministrit përgjegjës për sportin.

NENI 31

Hyrja në fuqi

Ky Statut i OKAD-së hyn në fuqi pas vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, Tiranë.

Më __/__/__



KLODIAN ALLAJBEU

Nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar